



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.186, datë 27.06.2023

PËR

**“RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN VAKANT NR.3 NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË, SHPALLUR ME VENDIMIN
NR.92, DATË 09.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 43 dhe 44 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin vakant Nr.3, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.92, datë 09.05.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si më poshtë:
 1. Eranda Felaj
 2. Asllan Barjamaj
 3. Julian Çafka
 4. Gentian Habazaj
 5. Ervisa Hyka
 6. Gëzim Veizi
 7. Suela Beluli
- II. Mos vazhdimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatët Enkeleda Hoxha dhe Gëzim Spahiu.
- III. Përfundimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatin Bledar Bejko.
- IV. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- V. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
- VI. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

VIII. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2023.



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
Alfred Balla

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Nuriman Seiti

ANËTAR
Elaida Goxhi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Ledina Riza